



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 20, datë 29.04.2026

PËR
REFUZIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“KOMPLEKS TURISTIK 1-2 KATE, ME 3 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË
BASHKINË HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Nenit 25 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Refuzimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks turistik 1-2 kate, me 3 kate nëntokë”, me vendndodhje në bashkinë Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “5D Konstruksion” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij Vendimi, lejohet ankim nga pala e interesuar, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Ligj Nr. 44/2015 “Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 13 07 2026